



**TED
KACZYNSKI**

**DINAKERIA ME
TINEZARE E
\$ISTEMIT**



TED KACZYNSKI

DINAHERIA ME TINEZARE E SISTEMIT

Përktheu: Baba Mondi

Redaktoi: Juxhin Halo

© Botimet BRERORE

brerore@outlook.com

2024

“Luksi e pran i shoqërisë së domosdoshmërisë teknike, do jetë bonusi i një revolte të padobishme e shoqëruar me një buzëqeshje prej të nënshtruarit”

– Jacques Ellul: “Shoqëria Teknologjike”

Sistemi ua ka bërë me hile të ashtuquajturve revolucionarë dhe rebelë të ditëve të sotme. Kjo hile është aq e lezetshme, sa që po të ish planifikuar me vetëdije, do duhej admiruar për elegancën pothuaj matematikore.

1. Sistemi nuk është...

Nisim duke qartësuar përbërjen e Sistemit. Sistemi nuk përbëhet nga George W. Bush dhe këshilltarët e tij, nuk përbëhet nga policët që keqtrajtojnë protestuesit, nuk përbëhet nga sipërmarrësit e korporatave shumëkombëshe, nuk përbëhet nga Frankenshtajnet e laboratoreve të modifikimit gjenetik. Të gjithë këta njerëz janë shërbëtorët e Sistemit, por nuk e përbëjnë Sistemin.

Në veçanti, vlerat, sjelljet dhe besimet personale dhe individuale të këtyre njerëzve mund të jenë fare mirë në konflikt domethënës me nevojat e Sistemit.

Përshembull, Sistemi kërkon respektimin e të drejtës së pronës, mirëpo sipërmarrësit, policët, dhe shkencëtarët edhe vjedhin ndonjëherë (kur flasim për vjedhjen nuk kufizohemi tek marrja e paligjshme e objekteve fizike. Mund të përfshijnë të gjitha mënyrat e paligjshme e marrjes së pronave, si përshembull shmangia e taksave, rryshfeti ose ndonjë trajtë e ndryshme e korrupsionit).

Mirëpo fakti që sipërmarrësit, policët, shkencëtarët dhe politikanët ndonjëherë vjedhin, nuk e bën vjedhjen pjesë përbërse të Sistemit.

Përkundrazi, sapo ndonjë polic apo politikan vjedh, ai rebelohet kundër kërkesës së Sistemit për të respektuar ligjin dhe të drejtën e pronës.

Në të njejtën kohë, teksa vjedhin, këto njerëz mbeten shërbëtorë të Sistemit, për sa kohë mbështesin publikisht ligjin dhe të drejtën e pronës.

Secila vepër e paligjshme që kryhet nga politikanët, policët apo sipërmarrësit: vjedhja, rryshfeti dhe shantazhi, nuk janë pjesë përbërëse të Sistemit, vetëm sëmundje. Sistemi funksionon mirë kur vjedhjet janë të pakta, prandaj shërbëtorët dhe fuqizuesit e Sistemit gjithmonë përkrahin bindjen ndaj ligjit publikisht, ndonëse u leverdis ta shkelin prapa perdes.

Marrim një shembull tjetër. Ndonëse policia janë përforcuesit e Sistemit, brutaliteti i policisë nuk është pjesë përbërëse e Sistemit. Kur policët rrahin për vdekje ndonjë të dyshuar, s'bëjnë punën e Sistemit, vetëm nxjerrin sheshit inatin e tyre. Qëllimi i Sistemit nuk është as brutaliteti dhe as nxjerrja e inatit.

Përsa i përket policëve, qëllimi i Sistemit është të shtrëngojë njerëzit për tu bindur, me sasi minimale të dhunës, prishjes së qetësisë, dhe publicitetit të keq. Pra, sipas pikëpamjes së Sistemit, polici ideal nuk inatoset, nuk përdor më tepër dhunë se ç'duhet, mbështetet tek manipulimi dhe jo tek forca, për t'i mbajtur njerëzit nën kontroll. Brutaliteti i policisë, është vetëm sëmundja e radhës e Sistemit, jo pjesë përbërëse e tij.

Nëse doni prova, këqyrni sjelljen e mediave kryesore. Mediat kryesore përgjithësisht e dënojnë brutalitetin policor. Padyshim që sjellja e mediave kryesore

përfaqëson konsensusin e opinionit ndërmjet klasave të fuqishme të shoqërisë sonë, mbi të mirat e Sistemit.

Çka u tha mbi vjedhjen, shantazhin dhe brutalitetin policor zbatohet gjithashtu tek problemet e diskriminimit dhe viktimizimit pors racizmi, seksizmi, homofobia, varfëria dhe keqtrajtimi i punëtorëve.

Në përmbajtje të teknologjisë moderne qëndron transporti i shpejtë nëpër largesa të gjata, që prish menyrat tradicionale të jetesës, përzien popullatat e ndryshme, prandaj në kohët e sotme njerëzit e racave, kombësive, kulturave dhe religjioneve të ndryshme duhet të jetojnë dhe të punojnë së bashku.

Nëse njerëzit urrejnë apo përjashtojnë njëri-tjetrin nëpër themele racore, etnike, religjioze apo seksuale, përfundimi i këtyre konflikteve ndërhyt tek funksionimi i Sistemit. Përjashtojnë këtu disa relike të lashta dhe të fosilizuara të së shkuarës si Jesse Helms, udhëheqësit e Sistemit e kuptojnë mirë këtë çështje, prandaj na mësohet nëpër shkolla dhe nëpër media si të besojmë që racizmi, seksizmi, homofobia dhe të tjera janë të këqija shoqërore që duhen eliminuar.

Padyshim, disa prej udhëheqësve të Sistemit, disa prej politikanëve, shkencëtarëve dhe sipërmarrësve, vetes u thonë që vendi i gruas është shtëpia, ose që homoseksualizmi dhe përzjerja e racave fenomene të pështira.

Mirëpo edhe sikur shumica e tyre të përkrahnin të kundërtën, sërish nuk mund të themi që racizmi, seksizmi

dhe homofobia janë pjesë përbërëse të Sistemit – aq më pak që vjedhja është pjesë përbërëse e Sistemit kur udhëheqësit vjedhin. Sistemi duhet të frymëzojë respekt ndaj ligjit dhe pronës për hir të qendrueshmërisë së tij, Sistemi duhet të ndëshkojë racizmin dhe forma të tjera të viktimizimit, për të njejtën arsye. Pavarësisht vendimeve vetjake të anëtarëve të Elitës, Sistemi është i përkushtuar ndaj shtypjes së diskriminimit dhe viktimizimit.

Vështrojmë sërish sjelljen e mediave kryesore. Pavarësisht mosbindjes rastësore dhe të butë prej disa reaksionarëve guximtarë dhe të pakët, propaganda mediatike përkrah barazinë gjinore, racore, si dhe pranimin e homoseksualitetit dhe përzierjes së racave.

Sistemit i nevojitet një popullatë e plogësht, e butë, e shtëpiakëzuar, delikate dhe e bindur. I nevojitet shmangia e çdo konflikti apo shqetësimi që mund të ndërhyjë me rendin e makinerisë shoqërore. Përveç shtypjes së armiqësive etnike, fetare dhe të tjera, duhet të shtypë ose të përthithë të gjitha tendencat e tjera që mund të përfundojnë në çrregullim dhe shqendërzim, si përshembull, maçizmi, impulset agresive, dhe çdo prirje të dhunshme.

Natyrisht, armiqësitë tradicionale etnike dhe racore, vdesin ngadalë, maçizmi, agresiviteti dhe impulse e dhunshme nuk shtypen lehtësisht, sjelljet përkundrejt seksit dhe identitetit gjinor nuk shndërrohen brenda natës.

Pra, ekzistojnë shumë individë që u bëjnë qëndresë këtyre ndryshimeve. Sistemi përballë me problemin e mbizotërimit ndaj kësaj qëndrese.

2. Si e shfrytëzon Sistemi impulsin për t'u rebeluar?

Njerëzit e shoqërisë moderne janë të ngjeshur me njëri-tjetrin në një rrjet të dendur rregullash dhe rregulloresh. Jemi nën mëshirën e organizatave të stërmëdha: korporata, institucione qeveritare dhe fetare, sindikata, universitete, parti politike – që na bëjnë të pafuqishëm.

Pasojat e pafuqisë, skllavërimit dhe shnjerezimit na dërgojnë tek impulsi për tu rebeluar. Pikërisht këtu Sistemi vë në lojë dinakërinë e tij më tinëzare, asi nën mëngë i Sistemit është shfrytëzimi i rebelimit në të mirën e tij.

Shumë njerëz nuk e kuptojnë rrënjën e irritimit të tyre, prandaj nuk i japin drejtim rebelimit. Janë të vetëdijshëm mbi domosdoshmërinë e rebelimit por s'dinë kundër kujt të rebelohen.

Fatmirësisht, Sistemi është i aftë t'ua përmbushë nevojat duke u ofruar një listë standarde dhe të zakonshme ankesash nëpër të cilat kanalizohet rebelimi: racizmi, homofobia, problemet e grave, varfëria, kushtet e punës...një kosh plot me të palarat e kauzave tipike të "aktivistëve".

**Shumë të ashtuquajtur rebelë e hanë karremin.
Teksa luftojnë racizmin, seksizmin etj, veç sa
përmbushin dëshirat e Sistemit. Pavarësisht kësaj,
imagjinojnë se po rebelohen ndaj Sistemit?**

Si ka mundësi?

Pesëdhjetë vjet para këtyre andrallave, Sistemi nuk i qe përkushtuar barazisë ndërmjet zezakësh, grash dhe homoseksualësh, veprimi në të mirë të këtyre kauzave ishte përnjëmend formë rebelimi.

Për pasojë, me kalimin e kohës këto kauza nisën të vështroheshin nga syri i rebelëve. Sot ato ruajnë po këtë status vetëm për hir të traditës; ngaqë përgjithësisht çdo brez rebelësh imiton brezat pararendës.

E dyta, gjendemi para një numri të konsiderueshëm njerëzish që i bejnë qendresë ndryshimeve shoqërore të kërkuara nga Sistemi, disa prej këtyre njerëzve janë pjesë e policisë, gjykatës dhe politikës. Këta qëndrestarë janë shënjestër e të ashtuquajturve rebelë, njerëz që duhen luftuar.

Komentatorë politikë si përshembull Rush Limbaugh i vijnë në ndihmë procesit duke ulëritur kundër aktivistëve; aktivistët mbeten brenda iluzionit të rebelimit teksa përjetojnë këtë kundërpërgjigje.

E treta, në mënyrë që të zgjerojnë konfliktin me shumicën e udhëheqësve të Sistemit që i pranojnë ndryshimet shoqërore me bindje të plotë, të ashtuquajturit rebelë këmbëngulin në zgjidhje më të skajshme në raport me udhëheqjen e kujdesshme të Sistemit, tërbohen nëpër çështje të parëndësishme. Përshembull, kërkojnë reparacione për zezakët, dhe

tërbohen sa herë që ndonjë grup minoritar kritikohet, edhe pse me të drejtë.

Kështu, aktivistët mirëmbajnë iluzionin e rebelimit ndaj Sistemit. Mirëpo ky iluzion është absurd. Trazirat kundër racizmit, seksizmit, homofobisë e të tjera përbën po aq rebelim ndaj Sistemit sa trazirat kundër vjedhjes dhe korrupsionit.

Kushdo që punon kundër vjedhjes dhe korrupsionit, nuk rebelohet kundër sistemit, bën punën e përforcuesve të Sistemit.

Duan t'i bëjnë politikanët të bindur ndaj rregullave të Sistemit. Kushdo që punon kundër racizmit, seksizmit dhe homofobisë po njëllon vepron si përforcues të Sistemit. I vijnë në ndihmë Sistemit kundër sjelljeve deviante, raciste, seksiste dhe homofobike që i hapin probleme Sistemit.

Aktivistët jo vetëm janë përforcues të Sistemit, por shërbejnë edhe si pikë referimi duke e larguar mospëlqimin dhe mosbindjen prej rrezes së Sistemit dhe institucioneve përkatëse. Sistemit i leverdis ta largojë gruan nga shtëpia dhe ta dërgojë tek vendi i punës për disa arsye.

Para pesëdhjetë vitesh, Sistemi i përfaqësuar nga qeveria ose media pat nisur nga hiçi një fushatë propagandistike të drejtuar për kah frymëzimi i zhvendosjes së gruas nga jeta shtëpiake drejt karrierës. Qëndresa natyrore njerëzore ndaj ndryshimit do të kish shkaktuar kunëdrshime të gjera publike.

Qendrën e udhëheqjes këto ndryshime e gjetën tek feminizmi radikal. Sistemi dhe institucionet ua vunë litarin në qafë dhe i ndiqnin hap pas hapi.

Kundërshtimi i konservatorëve shënjestroi feministët, jo Sistemin dhe insitucionet e tij, sepse ndryshimet shoqërore të sponsorizuara nga Sistemi dukeshin të ngadalta dhe të moderuara në raport me zgjidhjet radikale të mbështetura nga feminizmi radikal. Madje, këto ndryshime të ngadalta dukeshin sikur qenë imponuar në Sistem prej presionit të radikalëve.

3. Dinakëria më tinëzare e Sistemit.

Në thelb, dinakëria më tinëzare e Sistemit vijon si më poshtë:

Për shkaqe sigurie dhe efektshmërie, Sistemi duhet të frymëzojë ndryshime të thella dhe radikale, për t'u përshtatur me gjendje vazhdimisht të ndryshme, që burojnë prej progresit teknologjik.

Vështirësimi i jetës nën rrethanat e imponuara nga Sistemi prodhojnë impulse të rebelimit.

Impulset e rebelimit përthithen nga Sistemi në të mirë të ndryshimeve shoqërore të kërkuara prej Tij: aktivistët "rebelohen" kundër vlerave të vjetra dhe të prapambetura që në fakt nuk i nevojiten më Sistemit, në të mirë të vlerave të reja që për Sistemin janë të domosdoshme për tu pranuar.

Kështu, impulsive të rebelimit që do kishin qenë të rrezikshme për Sistemin, u jepet një fushë veprimi që jo vetëm nuk e dëmton Sistemin, por e ndihmon.

Shumçka prej kundërshtimit publik që rezulton nga imponimi i ndryshimeve shoqërore, devijohet prej Sistemit dhe institucioneve përkatëse duke u kanalizuar tek lëvizjet e ndryshme që i prijnë këtyre ndryshimeve shoqërore.

Kjo dinakëri nuk planifikohet drejtpërsëdrejti dhe paraprakisht nga udhëheqësit e Sistemit, të cilët s'janë të

ndërgjegjshëm as për dinakërinë e tyre. Funksionon pakashum kështu:

Pronarët e medias, teksa orvaten të pozicionohen siç duhet në lidhje me ndonjë çështje, drejtpeshojnë me ose pa vetëdije disa faktorë. Duhet të mendojnë si do jetë reagimi i lexuesit apo shikuesit, duhet të vrasin mendjen për reklamuesit, miqtë e tyre, njerëz të fuqishëm rreth e rrotull, por mbi të gjitha duhet ta vrasin mendjen mire për sigurinë e Sistemit.

Këto konsiderata praktike zakonisht i nxjerrin jashtë loje ndjenjat e tyre vetjake mbi çështjen. Ndjenjat vetjake të personave mediatikë, njerëzve të fuqishëm dhe të reklamuesve janë të shumëllojshme.

Mund të jenë liberalë, konservatorë, fetarë ose ateistë. Fusha e përbashkët e veprimit midis këtyre udhëheqësve është përkushtimi i tyre ndaj Sistemit, sigurisë sistemike dhe pushtetit sistemik. Parimi kryesor që drejton sjelljet e orientuara nga media tek publiku, është konsensusi i opinionit midis mediatikëve dhe njerëzve të fuqishëm mbi të Mirën e Sistemit.

Pra, sa herë që një redaktor apo njëfarëlloj udhëheqësi mediatik nis të vendosë çfarë sjelljeje të ndërmarrë kundrejt një lëvizjeje apo një kauze, mendja i shkon fillimisht tek pasojat në të mire ose në të keq të Sistemit. Ndoshta pëlqejnë tu thonë vetes që vendimet po merren në themele morale, filozofike ose fetare, por faktet provojnë që siguria e Sistemit ndodhet në radhë të parë ndërmjet faktorësh.

Përshembull, nëse redaktori i një reviste lajmesh merret me një lëvizje militante, ai mund të ndjejë simpati për disa nga qëllimet dhe vuajtjet e kësaj lëvizjeje, mirëpo në të njejtën kohë ai është i ndërgjegjshëm se ndërmjet financuesve dhe kolegëve të tij ekziston një konsensus mbi rrezikshmërinë e kësaj lëvizjeje ndaj Sistemit, prandaj nxiton t'i shkruajojë.

Në këto rrethana ai është plotësisht i bindur që revista duhet të mbajë një qëndrim negative ndaj lëvizjes militante. Supozohet që sjelljet negative të medias janë pjesë përbërëse e arsyes pse një lëvizje bie dhe vdes.

I njejtë redaktor teksa merret me feminizmin radikal, mendon që zgjidhjet radikale të propozuara janë të rrezikshme për Sistemin, mirëpo gjithashtu mendon se feminizmi është i dobishëm për Sistemin.

Pjesëmarrja e grave në sferën e biznesit dhe të teknologjisë, do t'i integronte ato dhe familjet e tyre më së miri në Sistem. Aftësitë e tyre do të viheshin në shërbim të Sistemit në çështje teknike dhe biznesore. Theksi feminist në dhënien fund të përdhunimit dhe abuzimit gjithashtu i shërben nevojave të Sistemit, meqë përdhunimi, abuzimi dhe forma të tjera të dhunës përbëjnë rrezikshmëri për Sistemin.

Mbi të gjitha, redaktori ndjen se kotësia e punëve të rëndomta të shtëpisë dhe izolimi shoqëror i një gruaje shtëpiake mund t'i frustrojë gratë tej mase, frustrim i cili sjell probleme për Sistemin përveçse në rastet që grave

u lejonet një ventilim nëpërmjet karrierës në sferën e teknologjisë dhe të biznesit.

Edhe nëse ky redaktor është maçist i cili ndihet rehat me gratë e nënshtruara, ai është i ndërgjegjshëm që feminizmi i moderuar është i mirë për Sistemin.

Ai e di më së miri se qëndrimi i tij editorial duhet të jetë i favorshëm ndaj feminizmit të moderuar, përndryshe do të përballet me mospajtimin e reklamuesve dhe njerëzve të tjerë të pushtetshëm. Ja pse sjelljet e mediave kryesore kanë qenë gjithnjë në mbështetje të feminizmit të moderuar, të përziera ndaj feminizmit radikal, dhe vijimësisht armiqësore ndaj qëndrimeve të skajshme feministe.

Nëpërmjet këtij procesi, lëvizjet rebele që përbëjnë rrezikshmëri ndaj Sistemit i nënshtrohen një propaganda negative, kurse lëvizjeve rebele të konsideruara si të dobishme për Sistemin, u jepet vëmëndje e kontrolluar nëpër media. Përthithja e pandërgjegjshme e propagandës mediatike ndikon mbi rebelët e njëmendtë, duke i bërë ata të “rebelohen” në mënyra që i shërbejnë Sistemit.

Intelektualet e universiteteve gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në përforcimin e Dinakërisë së Sitemit. Ndonëse pëlqejnë të vetëquhen “mendimtarë të pavarur”, intelektualët (përveç disa përjashtimeve të veçanta) janë grupi më i pashtyllë, më i mbishoqëruar, më konformist, më i zbutur dhe më i shtëpiakëzuar në Amerikën e sotme. Për rrjedhojë, impulsi i tyre për tu

rebeluar është i fortë. Mirëpo ngaqë janë të paaftë për të menduar në mënyrë të pavarur, rebelimi i njëmendtë është i pamundur për ta. Për pasojë, ata e thithin mirë Dinakërinë e Sistemit, që i lejon t’i irritojnë njerëzit dhe t’u gezohën iluzionit të rebelimit, pa i sfiduar kurrë vlerat themelore të këtij Sistemi.

Duke qenë se janë edukatorët e rinisë, intelektualët e universiteteve pozicionohen në të mirë të Sistemit, duke e ndihmuar t’ua luajë Dinakërinë – duke ua udhëzuar impulset rebeluese drejt shënjestrave standarde dhe stereotipike: racizmi, kolonializmi, problemet e grave, etj. Rinia pa shkollë të lartë, informohet mbi “revoltën” e studentëve për çështjet e “drejtësisë shoqërore” nëpërmjet medias ose shoqërizimit dhe nis t’i imitojë këto studentë. Në këtë mënyrë zhvillohet një kulturë rinore përmes të cilës gjallon një mënyrë stereotipike e rebelimit që përhapet nëpërmjet imitimit të shoqishojt – sikurse modelet e veshjes, të flokëve dhe zakone të tjera përhapen përmes imitimit.

4. Kjo Dinakëri nuk është e përkryer

Natyrisht që kjo Dinakëri e Sistemit nuk funksionon në mënyrë të përkryer. Jo të gjitha pozicionet e marra nga bashkësia e “aktivistëve” janë në përputhje me nevojat e Sistemit. Nisur nga kjo, disa nga vështirësitë më të rëndësishme që përbëjnë rrezik për Sistemin janë të lidhura me konfliktin midis dy llojeve të propagandës që Sistemit i duhet t’i përdorë, propaganda e integritimit dhe propaganda e agjitacionit.

Propaganda e integritimit, është mekanizmi parësor i shoqërizimit në shoqërinë moderne. Kjo propagandë ndërtohet mbi parimin e instalimit të sjelljeve, besimeve, vlerave dhe zakoneve në dobi të shndërrimit të njerëzve në vegla të sigurta të Sistemit.

U mëson njerëzve të shtypin ose të tejkalojnë impulse emocionale që përbëjnë rrezik për Sistemin. Përqëndrohet në modele të sjelljes afatgjatë dhe vlera të ngulitura thellë dhe gjerësisht të zbatueshme, jo në qëndrime kundrejt çështjesh specifike dhe të menjëhershme.

Propaganda e agjitacionit luan me emocionet e njerëzve, duke i bërë të sillen në një mënyrë të caktuar, në një situatë të caktuar. Në vend se t’i mësojë njerëzit si t’i shtypin impulset e rrezikshme emocionale, kërkon të stimulojë emocione të caktuara në të mirë të qëllimeve specifike të lokalizuara në kohë.

Sistemit i nevojitet një popullatë e renduar, e zbutur, bashkëpunuese, passive dhe e varur.

Mbi të gjitha i nevojitet një popullatë jo e dhunshme, meqë qeverisë i duhet të mbajë monopolin në përdorimin e dhunës. Për këtë arsye, propaganda e integritit na mëson si të tmerrohemi nga dhuna, të mos tundohemi ta përdorim edhe kur jemi krejtësisht të inatosur (me dhunë kuptoj sulmet fizike të qenieve njerëzore).

Në përgjithësi, propaganda e integritit synon të na mësojë vlera të buta dhe përkëdhelëse që vendosin theksin tek ndërvarësia, bashkëpunimi dhe pasiviteti.

Nga ana tjetër, në kontekste të caktuara, vetë Sistemi i konsideron metodat brutale dhe agresive si të domosdoshme për të mbërritur objektivat. Shembulli më i qartë i këtyre metodave është lufta. Në kohë të luftës, Sistemi mbështetet tek propaganda e agjitacionit: në mënyrë që të fitojë pëlqimin e publikut, luan me emocionet e njerëzve duke i bërë të ndihen të frikësuar dhe të inatosur ndaj armiqve realë ose të supozuar.

Në këtë situatë, ekziston një konflikt midis propagandës së integritit dhe propagandës së agjitacionit. Personat e bombarduar me vlera të lehdave dhe frikë të dhunës, nuk mund ta japin lehtësisht pëlqimin ndaj një operacioni ushtarak të përgjakshëm.

Pra Dinakëria e Sistemit nganjëherë bën rikoshet. Aktivistët e “rebeluar”, skllëvër të vlerave të propagandës së integritit, vazhdojnë të “rebelohen” në

kohëra të luftës. Ata kundërshtojnë luftën, jo vetëm ngaqë është e dhunshme por ngaqë është "raciste", "kolonialiste", "imperialiste", etj, vlera të cilat janë negative në raport me ledhat dhe zbutjet e propagandës së integritimit.

Dinakëria e Sistemit gjithashtu bën rikoshet në rastin e keqtrajtimit të kafshëve. Shumë njerëz i projektojnë tek kafshët vlerat e buta dhe kundërshtinë ndaj dhunës të cilat i mësojnë përsa i përket njerëzve.

Ata tmerrohen nga masakrimi i kafshëve për mish, dhe nga praktika të tjera që lëndojnë kafshët, si përshembull reduktimi i pulave në makineri të prodhimit të vezëve ose përdorimi i kafshëve për eksperimente shkencore.

Deri në njëfarë pike, kundërshtimi i keqtrajtimit të kafshëve mund të jetë i dobishëm për Sistemin: Një dietë vegjetariane është më efiçente në terma të përdorimit të burimeve krahasuar me një dietë normale. Nëse njerëzit bëhen vegjetarianë, nuk do të jenë më barrë për rruzullin tokësor, nuk do tejkalojnë kufirin e përdorimit të burimeve – në raport të zhdrejtë me rritjen e popullsisë njerëzore.

Këmbëngulja e aktivistëve në ndalimin e përdorimit të kafshëve në eksperimente shkencore, është qartësisht në konflikt me nevojat e Sistemit, ngaqë të paktën në të ardhmen e afërt, nuk do të ketë një zgjidhje funksionale për zëvendësimin e kafshëve si subjekte të kërkimit shkencor.

Sidoqoftë, rikohet e pakta të Dinakërisë së Sistemit nuk shërbejnë si masa parandaluese të Dinakërisë në tërësi.

Duhet të themi që Dinakëria e përshkruar nuk është i vetmi faktor përcaktues i drejtimit që impulset e rebelimit marrin në shoqërinë tonë.

Shumë njerëz sot ndihen të dobët dhe të pafuqishëm (me arsye ngaqë Sistemi përnjëmend na dobëson dhe na bën të pafuqishëm), dhe nisin të identifikohen me viktimat, me të dobëtit dhe të shtypurit.

Kjo është një prej arsyeve pse çështjet e viktimizimit pors racizmi, seksizmi, homofobia dhe neokolonializmi janë bërë çështje standarde të aktivizmit modern.

5. Shembuj

Kam këtu me vete një tekst shkollor të antropologjisë, në të cilin kam vërejtur disa shembuj të këndshëm të mënyrës sesi intelektualët e universiteteve e ndihmojnë Sistemin në Dinakërinë e tij duke e maskuar konformizmin si kritikë të shoqërisë modern.

Shembujt më të këndshëm gjenden në faqet 132-36 ku autori citon në trajtë të përshtatur një artikull me autor Rhonda Kay Wiamson, një person interseks (person i lindur me tipare femërore dhe mashkullore).

Wiamson deklaron që Indianët e Amerikës jo vetëm i pranonin personat interseks por i vlerësonin. Ajo e vendos këtë sjellje në raport kundërtshënës me sjelljen Euro-Amerikane të cilën e barazon me mënyrën sesi prindërit ishin sjellë me atë vetë.

Prindërit e Wiamson e kishin keqtrajtuar mizorisht. E përbuznin për gjendjen e saj biologjike. I thoshin se ishte “e mallkuar dhe e dorëzuar tek djalli”, e dërgonin nëpër kisha karizmatike që t’ia nxirrnin djallin. I jepnin façoleta që ta kolliste djallin jashtë.

Mirëpo qartësisht, barazimi i kësaj sjelljeje me qëndrimet “Euro-amerikane” është qesharak. Kështu mund të përshkruhen qëndrimet Euro-amerikane të dy shekujve më parë, mirëpo në ditët e sotme çdo edukator i psikologjisë ose klerik, do të tmerrohej.

Mediat kurrë nuk do t'i paraqisnin sjelljet e këtilla si pozitive. Amerikani mesatar i sotëm, klasë e mesme, mbase nuk do e pranonte shumë gjendjen interseksuale, siç e pranonin Indianët, mirëpo të paktë do ishin ata që nuk do e pohonin mizorinë e treguar ndaj Wiamson.

Dukshëm, prindërit e Wiamson ishin të rrjedhur, të marrë pas fesë, besimet dhe sjelljet e të cilëve ishin në përputhje me vlerat e Sistemit. Pra, duke sulmuar shoqërinë modern Euro-amerikane, Wiamson në fakt po sulmon vetëm një minorancë të rrjedhur prej halabakësh kulturorë të cilët nuk i janë përshtatur ende vlerave mbizotëruese të Amerikës së sotme.

Haviland, autori i librit të antropologjisë, në faqen 12 e portretizon antropologjinë kulturore si një lëvizje ikonoklaste, sfiduese ndaj supozimeve të shoqërisë modern Perëndimore.

Kjo punë është aq larg të vërtetës sa do ishte qesharake po të mos ishte patetike. Antropologjia moderne Amerikane është e nënshtruar ndaj supozimeve dhe vlerave të Sistemit.

Antropologët e sotëm pretendojnë se sfidojnë vlerat e shoqërisë, mirëpo sfidojnë vetëm vlerat e së kaluarës – vlera të tejkaluara dhe boshe që mbahen vetëm nga disa të rrjedhur dhe nga disa halabakë të cilët nuk janë përditësuar me ndryshimet kulturore të Sistemit.

Përdorimi i artikullit të Wiamson nga Haviland, e ilustron këtë punë fare mirë, dhe përfaqëson kahjen e përgjithshme të librit. Haviland luan me fakte etnografike

që japin mësim politikisht korrekte, mirëpo nënvlerëson ose heq tërësisht fakte etnografike që janë politikisht jo korrekte.

Pra, duke cituar historinë e Wiamson për ta vënë theksin tek pranimi i personave interseksualë nga Indianët, ai nuk e përmend që ndërmjet fiseve Indiane praktikohesh prerja e hundës në raste tradhtie bashkëshortore vetëm kur tradhtia kryhej nga femrat; ose që në Indianët e fisit të Korbit, luftëtari që goditej nga një i huaj duhet ta vriste të huajin menjëherë përndryshe turpërohej para fisit.

Haviland nuk merret as me përdorimin e torturës nga fiset Indiane të ShBA-ve Lindore. Fakte të këtilla që përfaqësojnë dhunën, maçizmin dhe diskriminimin në baza gjinore janë të papranueshme, prat ë papërputhshme me vlerat e sotme të Sistemit, prandaj duhen censuruar si politikisht jo korrekte.

Nuk e vë në dyshim që Haviland beson sinqërisht që antropologët e sotëm i sfidojnë supozimet e shoqërisë Perëndimore. Kapaciteti për vetëmashtrim i intelektualëve universitare shkon shumë larg.

Përfundimisht, dua të qartësoj se nuk po sugjeroj që prerja e hundës është ndëshkim i përshtatshëm ndaj tradhtisë bashkëshortore, ose që abuzimi i grave duhet toleruar, as nuk dua të vërej që ndokënd përbuzed ose mohohet ngaqë janë interseksuale, ose prej racës, religjionit, orientimit skesual, etj etj.

Mirëpo në shoqërinë tonë këto çështje janë punë reforme. Dinakëria më tinëzare e Sistemit mbetet e njejtë – shndërrimi i impulseve të fuqishme të rebelimit, që në situatë të tjera do të kishin marrë kthesën e revolucionit, në vegla të dobishme të këtyre reformave modeste.